REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Procesverbali i Mbledhjes

Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore

Mbledhja e datës 9 nëntor 2026

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes 2
1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2024, "Për sigurinë kibernetike"" dhe projektvendimi për propozimin e ligjit për "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2024, "Për sigurinë kibernetike""……..2
2. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën" i ndryshuar …..3
3. Projektvendimi Projektvendimi "Për menaxhimin e mbetjeve minerare"…….4
4. Projektvendimi "Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte" ……...6
5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile" 8
Mbyllja e mbledhjes 10
Shtojcë: Të pranishëm 10

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 17.4.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", më datë nëntor 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ. Mbledhja plenare u zhvillua në orën 10:00, në platformën Microsoft Zoom, online. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe përfaqësues të institucioneve qendrore propozuese të projektakteve. Mbledhja u kryesua nga z. Oltjon Muzaka, Zëvendësministër i Punëve të Brendshme dhe z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve, bashkëkryetarë të Këshillit Konsultativ.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA:

1. **Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2024, "Për sigurinë kibernetike"" dhe projektvendimi për propozimin e ligjit për "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2024, "Për sigurinë kibernetike""** propozuar nga Auroriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (Kryeministria),u prezanrua nga znj. **Irma Droboniku**, përfaqesuese nga Auroriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Znj. Irma Droboniku u fokusua në nevojën për ndërhyrje ligjore në kuadrin normativ të sigurisë kibernetike në Shqipëri. Projektligji parashikon disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 25/2024 "Për Sigurinë Kibernetike", një kuadër ligjor i cili është i përafruar tërësisht me direktivën NIS 2 të Bashkimit Evropian. Nevoja për këto ndryshime ka lindur drejtpërdrejt nga përvoja e fituar gjatë zbatimit të deritanishëm të ligjit, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe eficiencës së masave mbrojtëse në vend. Përfshirja e pushtetit vendor në këtë diskutim është konsideruar thelbësore, pasi një pjesë e madhe e bashkive dhe organeve të tjera vendore klasifikohen si infrastruktura kritike ose të rëndësishme, duke u ndikuar drejtpërdrejt nga ky projektligj.

Një nga ndryshimet më kryesore teknike dhe strukturore lidhet me qendrat sektoriale të reagimit ndaj incidenteve kibernetike. Në ligjin aktual, ngritja e këtyre qendrave për çdo sektor sillte me vete kosto mjaft të larta financiare, çka e bënte të pamundur zbatimin e tyre sipas modelit origjinal. Për këtë arsye, me kuadrin e ri propozohet që rreth 90 për qind e qendrave sektoriale të ngrihen pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), ndërsa pjesa tjetër të funksionojë pranë institucioneve rregullatore ose strukturave të tjera të sigurisë dhe mbrojtjes, sipas parashikimeve të nenit 11. Përveç riorganizimit të qendrave sektoriale, projektligji sjell edhe një risi të rëndësishme si krijimin e Rrjetit Ndërinstitucional të Inteligjencës Kibernetike. Kjo strukturë e re ka për qëllim shkëmbimin dhe kryqëzimin e informacionit operativ ndërmjet institucioneve kyçe të sigurisë në vend, si SHISH, Policia e Shtetit dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes. Përmes këtij bashkëpunimi, autoritetet synojnë të identifikojnë më herët kërcënimet dhe të mundësojnë parandalimin e incidenteve përpara se ato të shkaktojnë dëme në infrastrukturat kibernetike. Një tjetër aspekt i rëndësishëm lidhet me mbikëqyrjen dhe auditimin e masave të sigurisë. Me rritjen e vazhdueshme të numrit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme nga 215 që ishin në vendimin e parë të Këshillit të Ministrave në mbi 300 aktualisht, kontrolli i drejtpërdrejtë nga autoriteti mbikëqyrës bëhet gjithnjë e më i vështirë për t'u realizuar në mënyrë

të shpeshtë. Për këtë arsye, përmes nenit 9 të projektligjit (që shton nenet 21 dhe 22), vendoset mekanizmi i deklarimit të masave të sigurisë dhe vetëdeklarimit të auditimit me periodicitet njëvjeçar, duke garantuar kështu një kontroll të rregullt dhe me afate më të shkurtra. Në përfundim, u theksua se projektligji sjell edhe forcimin e kuadrit të certifikimit të sigurisë kibernetike për produktet që hyjnë në treg, si dhe ashpërsimin e masave administrative. Penalitetet e reja synojnë të ndëshkojnë posaçërisht rastet kur subjektet kritike refuzojnë apo mosdorëzojnë informacionin e kërkuar nga autoriteti përgjegjës. Sa i përket procedurave ligjore, znj. Droboniku nënvizoi se projektligji ka kaluar të gjitha fazat e nevojshme të konsultimit publik, duke përfshirë një periudhë 30-ditore në platformën zyrtare dhe dëgjesa publike me përfaqësues të sektorëve publikë dhe privatë.

2. **Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"" i ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u prezantua nga Z. **Rudin Qehajaj,** Përgjegjës, Sektori i Peshkimit dhe z. Vasjar Shërmadhi, Drejtor, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Z.Vasjar Shërmadhi e nisi fjalën e tij duke theksuar se ndryshimet ligjore në fushën e akuakulturës janë hartuar me qëllimin kryesor për të krijuar një kuadër legjislativ sa më praktik, sa më atraktiv me nevojat e sektorit. Ai nënvizoi se duhet të jemi të vetëdijshëm se akuakultura përfaqëson të ardhmen e peshkimit, pasi sot rreth 56 për qind e produkteve vijnë pikërisht nga prodhimi i akuakulturës dhe jo nga peshkimi i drejtpërdrejtë në det. Në këtë kuadër, ai veçoi potencialin e jashtëzakonshëm që ka Shqipëria për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori, duke sqaruar se vëmendja nuk është vetëm te marikultura (e cila pak a shumë tashmë është e rregulluar dhe e sistemuar me zonat e saj përkatëse), por veçanërisht te zhvillimi i akuakulturës në ujërat e brendshme. Një nga elementët më kyç dhe më thelbësorë që ai nënvizoi ishte zgjidhja e çështjes së përdorimit të tokës. Pas një periudhe të gjatë, përmes këtij propozimi ligjor është lejuar zyrtarisht që toka me status bujqësor të mund të përdoret edhe për aktivitetin e akuakulturës. Kjo adreson drejtpërdrejt një pengesë të madhe administrative e ligjore që frenonte zhvillimin e sektorit, siç është rasti i fermave të vendosura në Kavajë ku statusi bujqësor i pronës bëhej pengesë. Në përmbyllje, z.Shërmadhi ritaksoi se i gjithë ky ndryshim është bërë me vetëdijen se ligji duhet t'u shërbejë realisht njerëzve dhe subjekteve, duke e bërë procesin sa më të thjeshtë, më të prekshëm dhe më funksional për të gjithë operatorët e akuakulturës në terren.

3. **Projektvendimi "Për menaxhimin e mbetjeve minerare",** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, u prezantua nga z, **Dhori Dapi.** Drejtor i Drejtorisë së Programeve dhe Zhvillimit të Indrustrisë Minerare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Z. Dhori Dapi theksoi se ligji synon përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian, në kuadër të hapjes së Kapitullit 27 të negociatave për anëtarësim. Për të shmangur fragmentimin e kuadrit ekzistues (ligji 10.304), nisma e re me 10 kapituj dhe 37 nene rregullon posaçërisht mbetjet minerare metalore nga kërkim-zbulimi e shfrytëzimi deri te përpunimi, duke përjashtuar mbetjet radioaktive, energjetike, gërmimet natyrore dhe hidrokarburet. Qëllimi kryesor është parandalimi i ndikimeve negative në mjedis e shëndet në të gjithë ciklin e jetës së mbetjeve, si dhe nxitja e riciklimit të tyre. Mbetjet klasifikohen në dy kategori: Kategoria A përfshin objektet me rrezik të lartë që kërkojnë plane emergjence, sisteme rigoroze sigurie dhe informim publik, ndërsa Kategoria B i nënshtrohet detyrimeve më të lehta të vetë-monitorimit.

Lejet e menaxhimit miratohen nga ministri (pa miratim në heshtje) dhe planet përkatëse rishikohen çdo 5 vjet. Ligji mbulon të katër fazat: ndërtimin, operimin, mbylljen dhe pasmbylljen me masa mbrojtëse për ujërat, ajrin dhe tokën. Subjektet detyrohen të paraqesin garanci financiare (të përditësuara çdo 2 vjet sipas inflacionit) për të mbuluar rehabilitimin dhe monitorimin pasmbylljes. Po ashtu, parashikohet një inventar kombëtar për objektet e braktisura dhe masa ndëshkuese nga gjobat deri te revokimi i lejeve. Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit, ndërsa aktet nënligjore dhe përshtatja e operatorëve do të kryhen brenda 6 deri në 12 muajve.

Komente;

Në fjalën e saj, përfaqësuesja e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, znj. Adelina Farrici, ngriti shqetësimin se në draftin aktual të projektligjit për menaxhimin e mbetjeve minerare roli i qeverisjes vendore është mjaft i kufizuar, pasi parashikon vetëm përfshirjen e bashkive në konsultimin publik. Ajo theksoi se aktivitetet e industrisë nxjerrëse dhe venddepozitimet e mbetjeve minerale kanë impakt të drejtpërdrejtë në territorin, infrastrukturën, mjedisin dhe ekonominë e komuniteteve lokale. Për këtë arsye, znj. Farrici nënvizoi nevojën për rritjen e vendimmarrjes së pushtetit vendor përmes disa propozimeve konkrete për ndryshime në projektligj.

Së pari, znj. Farrici propozoi që te neni 7 kërkesa për miratimin e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare të shoqërohet me pëlqimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës ku do të zhvillohet aktiviteti. Për sa i përket lejeve, ajo kërkoi që te kriteret për lejen e kategorisë përkatëse të shtohet detyrimi për një vërtetim nga bashkia që vërteton se lokacioni i propozuar për venddepozitim është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor.

Së dyti, lidhur me monitorimin dhe transparencën, znj. Farrici propozoi ndryshime në nenin 25, me qëllim që raportet gjashtëmujore mbi stabilitetin dhe cilësinë e ujërave që operatorët i dërgojnë strukturës qendrore, t'i dërgohen njëkohësisht për dijeni edhe bashkisë përkatëse. Po ashtu, për nenin 24, ajo kërkoi që gjatë inspektimeve periodike gjashtëmujore të parashikohet me ligj edhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të inspektoratit vendor të mjedisit.

Së treti, për sa i përket nenit 26 për kundërvajtjet administrative dhe gjobave (që variojnë nga 50,000 deri në 2 milionë lekë), znj. Farrici propozoi që 50% e vlerës së çdo gjobë të arkëtohet dhe të kalojë drejtpërdrejt në buxhetin e bashkisë ku ka ndodhur shkelja. Kjo masë synohet të shërbejë si kompensim për dëmin mjedisor të shkaktuar në territorin lokal dhe me detyrimin ligjor që të përdoret vetëm për rehabilitimin e këtij dëmi.

Së fundi, te neni 14, ajo propozoi që procesi i certifikimit për rikthimin e territorit në gjendjen e mëparshme dhe përdorimi i tij i mëtejshëm pas mbylljes së objektit nga ministri, të shqyrtohet domosdoshmërisht edhe nga bashkia pritëse.

Në ndërhyrjen e tij reaguese, z. Kaskolli ,ekspert pranë Drejtorisë së Zhvillimit të Indrustrisë Minerare sqaroi se meqenëse bëhet fjalë për minierat metalore, bashkitë e prekshme janë të kufizuara gjeografikisht duke përmendur kryesisht Pukën, Mirditën, Bulqizën, Peshkopinë dhe disa bashki me miniera hekur-nikeli — mirëpo theksoi se asnjë bashki nuk do të përjashtohet.

Z. Kaskolli sqaroi se një pjesë e mirë e çështjeve dhe detajeve teknike të ngritura nga përfaqësuesja e bashkive do të jenë objekt i akteve nënligjore dhe anekseve përkatëse që do të kalojnë më pas. Ai pranoi parimisht shqetësimin e pushtetit vendor, duke pohuar se bashkitë kanë të drejtë të kërkojnë rol meqë aktiviteti zhvillohet drejtpërdrejt në territorin e tyre, ndonëse ngriti nevojën për kapacitete të specializuara profesionale gjatë analizave teknike.

Gjithashtu, z. Kaskolli i vuri në dukje se ky projektligj i kushton vëmendje të veçantë mbetjeve minerare metalore që gjenerojnë acide apo ndotje ujërash gjatë përpunimit (si në rastin e zonave të nxehta në Gjegjan/Kukës apo ish-damave të bakrit). Ligji synon që këto mbetje të futen në ekonominë qarkulluese për riciklim e përfitim produktesh, duke qenë se përmbajnë elemente kritike e minerale me vlerë strategjike për tregun evropian. Në mbyllje, ai vlerësoi diskutimin me përfaqësuesit e bashkive dhe u shpreh i hapur që një pjesë e propozimeve të merren parasysh dhe të përfshihen gjatë hartimit të akteve nënligjore.

Në replikën e saj përmbyllëse, znj. Farrici vlerësoi qasjen dhe ftoi drejtorin e ri që t'i shqyrtojë me vëmendje propozimet e Shoqatës së Bashkive për t'i përfshirë direkt në tekstin e projektligjit. Ajo sqaroi se kërkesat e tyre nuk synojnë të ndërhyjnë tek ekspertiza e lartë teknike e vendimmarrjes, por të sigurojnë që Këshilli Bashkiak të japë mendimin e tij pasi bëhet fjalë për vetë territorin lokal. Znj. Farrici përsëriti kërkesat kryesore që inspektorati i bashkisë të përfshihet në inspektime dhe që një pjesë e gjobave të shërbejë si kompensim për dëmin në territor, duke theksuar se edhe pse do të ketë akte nënligjore, do të ishte shumë më e mirë që këto parime të sanksionohen që në ligj.

Në sqarimin e tij përfundimtar, z.Edmond Kaskolli theksoi se nuk ekziston asnjë mundësi që Ministria të lëshojë një leje pa marrë më parë miratimin e pushtetit vendor dhe të Agjencive Rajonale të Mjedisit. Ai vuri në dukje se pa pëlqimin e pushtetit vendor nuk mund të merret leja mjedisore, dhe pa këtë të fundit procedura nuk mund të ecë më tej.

Z. Kaskolli sqaroi se marrja e mendimit të bashkisë dhe konsultimi me publikun e komunitetin lokal janë hapa plotësisht të detyrueshëm ligjërisht, pasi leja e menaxhimit të mbetjeve trajtohet si leje e zakonshme shfrytëzimi që e ka të parashikuar këtë filtri. Së fundi, lidhur me propozimin e znj. Farrici për ndarjen dhe kalimin e një pjese të gjobave në buxhetin e bashkisë, ai u shpreh se kjo është një çështje që vërtet meriton të diskutohet.

Z. Dalipi e falënderon zonjën Adelina Farrici për diskutimin e dobishëm, duke vlerësuar përvojën e saj të mëparshme si kryetare bashkie në ato zona. Ai thekson se ajo e njeh jashtëzakonisht mirë këtë çështje, si nga pikëpamja e ekspertizës, ashtu edhe sa i përket përshtatjes së qeverisjes vendore me këto procese. Në fund, ai pyet nëse ka diçka tjetër për të shtuar apo për ta përmbyllur diskutimin.

Znj. Farrici falënderon dhe mbyll ndërhyrjen e saj duke njoftuar se Shoqata e Bashkive do t'i dërgojë të gjitha këto rekomandime edhe zyrtarisht me shkrim, me qëllim që grupi i punës t'i shqyrtojë me vëmendje. Ajo shton se do të shohin se çfarë mund të përfshihet drejtpërdrejt në ligj dhe çfarë do të mbetet për t'u adresuar gjatë hartimit të akteve nënligjore.

Z. Dapi thekson se çështjet e ngritura janë plotësisht të hapura për diskutim dhe se përpjekja synon të bëhet më e mira për një problem kaq të rëndësishëm, veçanërisht për bashkitë me miniera metalore dhe mbetjet e trashëguara që nga viti 1994, të cilat për shkak të fizibilitetit apo çmimeve të tregut nuk janë futur ende në qarkullim. Ai nënvizon se ky projektligj po e rregullon këtë fushë me ligj për herë të parë, duke i trajtuar mbetjet jo thjesht si një damkë apo mbetje të braktisura, por duke u dhënë mundësinë të futen në ekonominë qarkulluese për të zvogëluar ndotjen dhe për të përfituar si shteti, ashtu edhe subjektet private e bashkitë. Në mbyllje, ai rikonfirmon se nuk përjashtohet asnjë diskutim dhe se ligji do të përmirësohet më tej përmes akteve nënligjore në vazhdim.

Znj. Ramaj, Drejtor për Menaxhimin e Mbetjeve nga Ministria e Mjedisit theksoi se ky projektligj hartohet për herë të parë në Shqipëri dhe është produkt i një bashkëpunimi të ngushtë me ekipin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Ajo nënvizoi se ligji përafron dhe transpozon për herë të parë direktivën përkatëse të BE-së, e cila është pjesë e kuadrit rregullator për mbetjet në kuadër të Kapitullit 27. Në mbyllje, znj. Ramaj u shpreh me optimizëm se miratimi i ligjit po ecën në rrugë të mbarë dhe brenda afateve të duhura për të përmbushur detyrimet për mbylljen e këtij kapitulli integrues.

Znj. Paparizo e nisi ndërhyrjen e saj duke përgëzuar grupin e punës për nismën dhe punën e bërë, duke qenë se bëhet fjalë për një ligj që nuk është prekur më parë. Ajo bëri me dije se stafi ka përgatitur komentet zyrtare me shkrim për këtë projektligj, të cilat mbështesin edhe propozimet e ngritura më parë nga znj. Farrici.

Në mënyrë të veçantë, znj. Paparizo veçoi disa tema kyçe të përgatitura nga ministria që kërkojnë vëmendje: përcaktimi i pjesëmarrjes së bashkive në vendimmarrjet që prekin territorin e tyre, bashkërendimi i planeve të emergjencës dhe njoftimi i menjëhershëm, financimi dhe përgjegjësia për objektet e braktisura, vazhdimësia e detyrimeve dhe garancive pas mbylljes, si dhe përshtatja institucionale e dokumentare me ligjin e organizimit territorial.

Në mbyllje, ajo shprehu se këto komente do të merren parasysh tani që projektligji është ende në fazën e draftimit ku mund të bëhen ndryshime e shtime, dhe njoftoi se pasi t'i përcjellin këto propozime me shkrim, do të evidentohet se cilat prej tyre do të reflektohen në draftin përfundimtar.

4. **Projektvendimi "Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte",** propozuar nga Ministria e Mjedisit, u prezantua nga znj, **Elvana Ramaj,** Drejtor, Drejtoria e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Z. Aldrin Dalipi prezantoi pikën e radhës të rendit të ditës, duke i dhënë fjalën znj. Elvana Ramaj, Drejtore në Drejtorinë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, pranë Ministrisë së Mjedisit, për të prezantuar projektvendimin "Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte".

Në prezantimin e saj, znj. Ramaj bëri një përmbledhje të bazës ligjore dhe qëllimit të projektvendimit, duke theksuar se ai mbështetet në ligjin nr. 52/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", konkretisht në nenin 34, pika 10. Ajo sqaroi se projektvendimi synon të krijojë një kuadër të qartë rregullator për administrimin e përkohshëm të mbetjeve inerte, duke parandaluar

depozitimin e paligjshëm të tyre dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit, tokës, ujërave dhe peizazhit.

U theksua se venddepozitimet e përkohshme do të shërbejnë si një zgjidhje kalimtare deri në ndërtimin dhe funksionalizimin e landfilleve rajonale për mbetjet inerte. Në këtë kuadër, Ministria e Mjedisit po punon për të mbështetur projektet për krijimin e këtyre infrastrukturave në secilën zonë të menaxhimit të mbetjeve.

Më tej, znj. Ramaj paraqiti kërkesat teknike dhe kushtet që duhet të plotësojnë venddepozitimet e përkohshme, ku përfshihen kufizimi fizik i territorit, kontrolli i hyrje-daljeve, mbajtja e regjistrave për mbetjet e depozituara, sistemet e drenazhimit të ujërave sipërfaqësore, masat për kontrollin e pluhurit, si dhe masat e sigurisë dhe emergjencës.

Ajo sqaroi se në këto venddepozitime do të pranohen vetëm mbetje inerte që vijnë nga proceset e ndërtimit dhe prishjes, si gurë, beton, tulla, tjegulla, materiale qeramike dhe materiale të tjera minerale të ngjashme. Ndërkohë, do të ndalohet pranimi i mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve urbane të përziera, mbetjeve të biodegradueshme, azbestit, baterive, pajisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe i përzierjeve të pakontrolluara të mbetjeve.

Lidhur me kohëzgjatjen e funksionimit, u bë e ditur se venddepozitimet e përkohshme do të kenë një afat maksimal prej tre vitesh, me mundësi shtyrjeje edhe për dy vite të tjera në raste të veçanta dhe të argumentuara, nëpërmjet një miratimi të dytë. Funksionimi i tyre do të ndërpritet në rast të përfundimit të afatit të miratuar, arritjes së kapacitetit të përcaktuar ose vënies në funksion të landfillit rajonal përkatës.

Në vijim, u trajtuan edhe detyrimet e operatorëve, të cilët duhet të garantojnë pranimin vetëm të mbetjeve të lejuara, mbajtjen e dokumentacionit dhe regjistrave përkatës, monitorimin mjedisor, raportimin periodik nëpërmjet Sistemit të Informacionit Mjedisor (SIM), si dhe zbatimin e planit të emergjencave. Gjithashtu, operatorët do të jenë përgjegjës për mbylljen dhe rehabilitimin e plotë të venddepozitimit pas përfundimit të aktivitetit.

Pas prezantimit, znj. Anxhela Paparizo, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), shprehu mbështetjen në parim për projektvendimin, duke paraqitur njëkohësisht disa rekomandime për rishikimin e mëtejshëm të tij përpara miratimit. Konkretisht, ajo vuri në dukje rëndësinë e qartësimit të regjimit juridik dhe të destinacionit përfundimtar të mbetjeve, përfshirjes së bashkive në procesin e konsultimit, përcaktimit të modelit të operimit dhe tarifimit, si dhe garantimit të financimit për rehabilitimin e venddepozitimeve nga të gjithë operatorët. Gjithashtu, ajo theksoi nevojën për të marrë në konsideratë organizimin territorial dhe garantimin e vazhdimësisë së procesit gjatë reformave territoriale.

Në përgjigje të rekomandimeve të paraqitura, znj. Elvana Ramaj u shpreh se ato do të shqyrtohen më në detaje. Ajo sqaroi se parashikimet për tarifat do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe rastet kur operimi kryhet nga shoqëri tregtare. Sa i përket rehabilitimit, theksoi se kjo mbetet përgjegjësi e operatorit deri në përfundimin e plotë të procesit të mbylljes dhe rehabilitimit të venddepozitimit. Në përfundim, ajo falënderoi për komentet dhe sugjerimet e paraqitura, duke vlerësuar se ato adresojnë problematika të rëndësishme të evidentuara edhe gjatë diskutimeve të mëparshme.

5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile" propozuar nga Ministria e Mbrojtjes, u prezantua nga z, **Stiljan Llavdaniti**, Drejtor, Drejtoria e Hartimit të Akteve Regullatore, Ministria e Mbrojtjes.

Në vijim të rendit të ditës, z. Aldrin Dalipi prezantoi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2019 'Për mbrojtjen civile'", duke i dhënë fjalën z. Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Akteve Rregullatore, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë prezantimit, z. Llavdaniti bëri të ditur se qëllimi kryesor i projektligjit është forcimi dhe konsolidimi i sistemit kombëtar të mbrojtjes civile dhe i kapaciteteve të tij, me synim uljen e riskut nga fatkeqësitë, mbrojtjen e jetës së qytetarëve, komuniteteve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit. Gjithashtu, ai theksoi rëndësinë e rritjes së efektivitetit të sistemit kombëtar në menaxhimin e fatkeqësive dhe përafrimit të kuadrit ligjor me Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian.

Në vijim, ai evidentoi problematikat që kanë nxitur nevojën për ndryshimet ligjore, duke përfshirë përmirësimin e koordinimit ndërmjet organeve kolegjiale gjatë situatave të emergjencave, qartësimin e roleve të strukturave kombëtare në përgjigjen ndaj emergjencave brenda dhe jashtë vendit, si dhe përcaktimin e procedurave për angazhimin e tyre në misionet e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së. Gjithashtu, u trajtua nevoja për rritjen e rolit të shtetit në mbështetjen e subjekteve të prekura nga fatkeqësitë, zbatimin e parimit të subsidiaritetit, qartësimin e statusit të shërbimit vullnetar të mbrojtjes civile dhe përcaktimin e detyrimeve për trajnim dhe zhvillim profesional të subjekteve që përfshihen në zbatimin e ligjit.

Sa i përket ndryshimeve kryesore, z. Llavdaniti u ndal te forcimi i sistemit kombëtar të menaxhimit të emergjencave, riformulimi i përbërjes dhe detyrave të Komitetit të Mbrojtjes Civile, si dhe qartësimi i rolit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) në mbështetje të Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile. Gjithashtu, projektligji parashikon procedura standarde për angazhimin e strukturave profesionale të mbrojtjes civile në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator për marrëdhëniet dhe detyrimet ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore.

Një pjesë e rëndësishme e prezantimit ju kushtua rolit dhe përgjegjësive të njësive të vetëqeverisjes vendore. U sqarua se projektligji prek drejtpërdrejt bashkitë nëpërmjet disa dispozitave, përfshirë nenin 27, i cili i përfshin ato në sistemin kombëtar të mbrojtjes civile, krijimin e Komisionit Vendor të Mbrojtjes Civile nën drejtimin e kryetarit të bashkisë, si dhe nenin 30, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Z. Llavdaniti theksoi se përgjegjësitë ekzistuese të bashkive do të vijojnë të mbeten në fuqi, por do të riformulohen dhe qartësohen me qëllim shmangien e paqartësive gjatë zbatimit. Këto përgjegjësi lidhen me vlerësimin e riskut, hartimin e strategjive dhe planeve vendore, informimin e komunitetit për rreziqet, sistemet e paralajmërimit të hershëm, menaxhimin e të dhënave, investimet parandaluese, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe menaxhimin e emergjencave në nivel vendor.

Ndër risitë e parashikuara u evidentua përcaktimi më i qartë i rolit parësor të bashkive në reduktimin e riskut dhe menaxhimin e situatave të krizës në nivel vendor, rritja e përgatitjes së komunitetit

nëpërmjet trajnimeve dhe ushtrimeve, si dhe përgjegjësia e re për verifikimin e planeve të menaxhimit të krizave të subjekteve private, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së tyre me planin vendor të emergjencave civile.

Gjithashtu, u trajtua organizimi i strukturave të mbrojtjes civile në nivel vendor. Në këtë drejtim, u bë e ditur se projektligji synon krijimin e një strukture të dedikuar për mbrojtjen civile pranë bashkive, me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe shmangien e problematikave që lidhen me organizimin aktual.

Në përfundim të prezantimit, z. Llavdaniti sqaroi se projektligji nuk parashikon efekte financiare shtesë në buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore apo në buxhetin e shtetit, pasi strukturat përkatëse janë tashmë të ngritura në nivel vendor. Gjithashtu, u bë e ditur se pas hyrjes në fuqi të ligjit, me vendim të Këshillit të Ministrave do të përcaktohen më konkretisht detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive në menaxhimin e emergjencave.

Fjala përmbyllëse

Në përmbyllje të mbledhjes, *z. Dalipi* falënderoi pjesëmarrësit dhe kujtoi se komentet dhe sugjerimet e njësive të vetëqeverisjes vendore mirëpriten dhe do t'u përcillen institucioneve propozuese për reflektim.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	**Emri Mbiemri**	**Pozicioni**	**Institucioni/Organizata**
1	Oltjon Muzaka	Zëvendësministër/Bashkëkryetar	Ministria e Brendshme/Këshilli Konsultativ
2	Aldrin Dalipi	Kryetar/Bashkëkryetar	SHKQSH/ Këshilli Konsultativ
3	Hantin Bonati	Zëvendësministër	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
4	Elda Xhumari	Zëvendësministër	Ministria e Mjedisit
5	Ervis Mooçka	SHKQSH/Kryetar	Këshilli i Qarkut Vlorë
6	Agron Ivanaj	SHKQSH/Kryetar	Këshilli i Qarkut Lezhë

Shënim: Materialet e diskutuara në mbledhjen e datës 9 nënor 2026 mund t'i gjeni në linkun e mëposhtëm:

https://qeverisjavendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2026/nentor-2026/

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ ***E-mail: keshilli.konsultativ@amvv..gov.al Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII", Tiranë, Shqipëri.***